URDHËR
Nr. 402, datë 15.9.2022

PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017, "PËR MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar; si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, "Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve", të ndryshuar, bëhet përditësimi, me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Rinovohen regjistrimet për 3 (tri) lëndë vepruese, nga të cilat, 1 (një) lëndë vepruese me rrezik të ulët, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) Zgjaten afatet e regjistrimit për 52 (pesëdhjetë e dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) Hiqen 4 (katër) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

ç) Zëvendësohen kushtet te kolona "Dispozitat specifike" për *Paraffin oils,* bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

1. RINOVOHEN REGJISTRIMET (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

1.1 LËNDA VEPRUESE *Straight Chain Lepidopteran Pheromones (aldehydes dhe alcohols)*

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	***Straight Chain Lepidopteran Pheromones*** *(aldehydes)*	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	1.9.2022	30.8.2037	Për zbatimin e parimeve uniformë, konkluzionet e raportit të rinovimit për *Straight Chain Lepidopteran Pheromones* të merren në konsideratë. T'i kushtohet vëmendje e veçantë efikasitetit të produkteve për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë ose substanca të veçanta ose përzierje të tyre kur vlerësojnë aplikimet për regjistrim. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.
	Straight Chain Lepidopteran Pheromones *(alcohols)*	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	1.9.2022	30.8.2037	Për zbatimin e parimeve uniformë, konkluzionet e raportit të rinovimit për *Straight Chain Lepidopteran Pheromones* të merren në konsideratë. T'i kushtohet vëmendje e veçantë efikasitetit të produkteve për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë ose substanca të veçanta ose përzierje të tyre kur vlerësojnë aplikimet për regjistrim.

						Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.

1.2 LËNDA VEPRUESE ME RREZIK TË ULËT *Straight Chain Lepidopteran Pheromones (acetates)*

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	***Straight Chain Lepidopteran Pheromones*** *(acetates)*	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	Detajet janë dhënë në Raportin e Rishikimit SANTE/10828/2021	1.9.2022	30.8.2037	Për zbatimin e parimeve uniformë, konkluzionet e raportit të rinovimit për *Straight Chain Lepidopteran Pheromones,* të merren në konsideratë. T'i kushtohet vëmendje e veçantë efikasitetit të produkteve për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë ose substanca të veçanta ose përzierje të tyre kur vlerësojnë aplikimet për regjistrim. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.

2. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

- **Deri më 31 korrik 2022:**

1. Bispyribac

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- **Deri më 31 maj 2023:**

1. Heptamaloxyloglucan

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- **Deri më 31 tetor 2023:**

1. Deltamethrin
2. Flufenacet
3. Fosthiazate
4. Chlorotoluron
5. Daminozide
6. MCPA
7. MCPB
8. Prosulfocarb
9. Fludioxonil
10. Clomazone
11. Bensulfuron
12. Sodium 5-nitroguaiacolate
13. Sodium o-nitrophenolate
14. Sodium p-nitrophenolate
15. Tebufenpyrad
16. Prothioconazole
17. Aclonifen
18. Metazachlor
19. Proquinazid

Gjithsej: 19 lëndë vepruese.

- Deri më 30 nëntor 2023:

1. Tritosulfuron
2. Chlormequat
3. Propaquizafop
4. Quizalofop-P-ethyl
5. Quizalofop-P-tefuryl

Gjithsej: 5 lëndë vepruese.

- Deri më 11 dhjetor 2023:

1. Flumetralin

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- **Deri më 31 dhjetor 2023:**

1. Amidosulfuron
2. Nicosulfuron
3. Clofentezine
4. Dicamba
5. Difenoconazole
6. Lenacil
7. Picloram
8. Bifenox
9. Diflufenican
10. Fenoxaprop-P
11. Fenpropidin
12. Dimethachlor
13. Etofenprox
14. Penconazole
15. Tri-allate
16. Triflusulfuron
17. Sulphur
18. Tetraconazole
19. Paraffin oils
20. Paraffin oil
21. 2-phenylphenol
22. Prohexadione
23. 8-hydroxyquinoline
24. Fenpyrazamine
25. Esfenvalerate

Gjithsej: 25 lëndë vepruese.

TOTALI: 52 (pesëdhjetë e dy) lëndë vepruese.

3. HIQEN LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

1.1,3-dichloropropene

Lënda vepruese 1,3-dichloropropene nuk është e miratuar.

2. Chloropicrin

Lënda vepruese chloropicrin nuk është e miratuar.

3. Isopyrazam

- Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *isopyrazam*, brenda datës 8 shtator 2022;

- Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *isopyrazam*, të përfundojë brenda datës 8 dhjetor 2022.

4. Penflufen

- Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *penflufen*, brenda datës 26 mars 2023;

- Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *penflufen*, të përfundojë brenda datës 26 shtator 2023.

Gjithsej: 4 (katër) lëndë vepruese.

4. ZËVENDËSOHEN KUSHTET TE KOLONA "DISPOZITAT SPECIFIKE"

1. Paraffin oils CAS No 64742-46-7, CAS No 72623-86-0 dhe CAS No 97862-82-3. Kolona "Dispozitat specifike" zëvendësohet si vijon: Pjesa A: Mund të regjistrohen vetëm për përdorime si insekticide, akaricide dhe fungicide. Pjesa B: Për implementimin e parimeve uniformë, konkluzionet e raportit të rishikimit për vajrat parafine CAS No 64742-46-7, CAS No 72623-86-0 dhe CAS No 97862-82-3, të merren parasysh.

Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e nevojshme.